



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2018, miratoi këtë

#### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë - Ministria e Punëve të Brendshme.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 07189-0, Zona kadastrale Prishtinë, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-07189-0, pasuri shoqërore e Kuvendit komunal, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3613 m<sup>2</sup> jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 500 m<sup>2</sup>.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është ndërtimi i objektit për ofrimin e sigurisë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.
- IV. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është afatgjatë, në periudhën për 99 vjet.
- V. Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij propozimvendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.

- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij propozimvendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë: Kërkesa nr. 05-353/01-0033758/18, e dt. 09.02.2018, certifikata e pronësisë, kopja e planit dhe destinimi për parcelën kadastrale me nr. 07189-0.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-134855/18, më 06.06.2018

